

Suli



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ENERGJISË
DHE INDUSTRIË

DREJTORIA E PERGJITHSHME E PLANIFIKIMIT STRATEGJIK ✓
PER MINIERAT DHE INDUSTRIE
DREJTORIA E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT TE MINIERAVE

Nr. *1188/*

Tirane, date *2.1.2015*

Drejtuar: Z.BARDHYL ÇANO
SHOQERIA "ALBAENERGJIPLUS" SH.P.K
RRUGA E KAVAJES,
KARBURANTI TEK ISH LIDHJA E SHKRIMTAREVE

TIRANE

Për njoftim: Z. DAEL DERVISHI, DREJTOR EKZEKUTIV
AGJENCIA KOMBETARE E BURIMEVE NATYRORE
BULEVARDI "BAJRAM CURRI" BLLOKU "VASIL SHANTO"

TIRANE

Z.RRAPUSH TOLA, DREJTOR
REPARTI INSPEKTIM-SHPETIMIT TE MINIERAVE
RRUGA "LORD BAJRON", LAPRAKE

TIRANE

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi te lejes nr.1406 date 01.09.2009.

I nderuar z. ÇANO,

Shoqëria "AlbaEnergjiaPlus" sh.p.k është zotëruese e lejes minerare te shfrytëzimit nr.1406 date 01.09.2009, për qymyr guri, vanadium, germanium, toka te rralla ne objektin "Shpoze", Qafe Priskë, ne Qarkun Tirane.

Nga struktura përgjegjëse AKBN me shkresën nr. 2414 date 18.02.2015, protokolluar ne Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë (MEI) me nr.1188 date 18.02.2015, është propozuar revokimi i lejes minerare te shfrytëzimit nr.1406 date 01.09.2009, për qymyr guri, vanadium, germanium, toka te rralla, ne objektin "Shpoze", Qafe Priskë, ne Qarkun Tirane, për arsye se nuk është filluar nga puna ne objekt edhe pse kane kaluar rreth 6 vite nga data efektive e dhënie se lejes.

Leja juaj është dhëne me Ligjin nr.7796 date 17.02.1994 "Minerar te Shqipërisë" te ndryshuar qe është shfuqizuar me ligjin nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar.

Sipas nenit 57 pika 2 dhe 3 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", përcaktohet shtrirja e efekteve edhe për lejet e dhëna përpara hyrjes ne fuqi te këtij ligji.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore për revokim është i mbështetur në paragrafin “ii”, të germën “b”, të pikës 1, të nenit 47 (neni që përcakton shkeljet ligjore për të cilat një leje revokohet) të ligjit nr.10304 datë 15.07.2010 “Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Sa më sipër në zbatim të nenit 48 të ligjit nr.10304 datë 15.07.2010 “Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë fillimin e procedurave të revokimit të leje minerare të shfrytëzimit nr.1406 datë 01.09.2009, për qymyr guri, vanadium, germanium, toka të rralla, në objektin “Shpoze”, Qafe Priskë, në Qarkun Tiranë, që shoqëria juaj zotëron.**

Ju bëjmë me dije se pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes nr.1406 datë 01.09.2009.

Në zbatim të nenit 49 të ligjit nr.10304 datë 15.07.2010 “Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit në të cilën keni ushtruar aktivitet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin

MINISTRI

DAMIAN GJIKNURI

